



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.779/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Sh.p.k, me adresë–Prishtinë, përfaqësuar nga Liman Musa, avokat në Ferizaj, kundër debitorit N.P.T, me adresë në Mitrovicë, përfaqësuar nga K.B., lidhur me pagesën e borxhit, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.11/2021, të datës 06.04.2021, jashtë seancës gjyqësore,më datë 23.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitorit N.P.T me adresë në Mitrovicë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.11/2021 të datës 06.04.2021, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin e atakuar, PPP.nr.11/2021, të datës 06.04.2021, ka vendosur si në vijim: “Refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.P.T, me adresë në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson K.B., ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.671/20 i dt.11.12.2020, sipas propozimit të kreditorit, Sh.p.k, me adresë – Prishtinë ”

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, me propozim që të aprovet ankesa e debitorit si e bazuar, të prishet aktvendimi i atakuar dhe lëndën t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosije.

Ankesa e debitorit i është dërguar përfaqësuesit të kreditorit, mirëpo i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Dhomës së dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori: Sh.p.k, me adresë – Prishtinë, me dt.10.12.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit N.P.T, me adresë në Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm faturës me nr.599 të dt.20.05.2019, për shumën e detyrimit në vlerë prej 1,538.18 euro.

Përmbartuesi Privat Besnik Aliu, me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, me Urdhri P.nr.671/2020 të dt. 11.12.2020, ka lejuar përmbartimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm - Fatura me nr..... të dt.20.05.2019, i plotëson kushtet për përmbartim.

Ndaj këtij urdhri, me datë 23.12.2020, debitori ka paraqitur prapësim, me propozim për gjykatën që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, të prishet urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.671/20 i dt. 11.12.2020, i Përmbartuesit Privat Besnik Aliu dhe të abrogohen të gjitha veprimet juridike në këtë çështje. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, me datë 12.01.2021, me propozim që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar, ndërsa urdhri për përmbartim të vërtetohet.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimit të debitorit, dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.11/2021, të datës 06.04.2021, ka refuzuar prapësimin e debitorit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se arsytet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohet përmbartimi i lejuar. Pretendimet e debitorit ku i referohet asaj se palët kanë pasur marrëveshje që çdo fund vit apo fillimin e vitit të ardhshëm kalendarik të bëjnë proces barazimin në koordinim të përbashkët, për konfirmimin e saldove financiare, gjykata i refuzoj si të pa bazuara, pasi që të njëjtat nuk janë arsye në bazë të cilave kreditori do të duhej ta priste debitorin pafundësisht përmbushjen e detyrimit. Më tej ka shtuar se kreditori me rastin e inicimit të procedurës përmbartimore, në përpikëri ka respektuar dispozitat e nenit 29 par 1 pika 1.3 dhe 3 të LPP-së. Gjykata në mungesë të argumenteve nga ana e debitorit, duke mos i aprovuar deklaratimet si në prapësimin e ushtruar, vendosi sikur në dispozitiv të të njëjtit konform nenit 69 par 4 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të

LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet për mosplotësimin e kushteve për lejimin e përmbarimit dhe as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata në procedurë përmbarimore e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit të besueshëm, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit përmbarimor dhe a ekzistojnë ndonjëra nga shkaqet për prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret, përmbarimi i lejuar me anë të dokumentit të besueshëm - faturës në të cilën është mbështetur gjykata e shkallës së parë, e që vlerësohet si e drejt nga kjo Dhomë, mbështetet në dispozitat ligjore nga neni 29 paragrafi.1 pika 1.3 dhe paragrafi. 3 të LPP-së me të cilin theksohet se: *“1. Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. faturat; ndërsa paragrafi. 3. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.* Nga dispozita e lartcekur shihet çartë se dokumenti me të cilin kreditori e ka kërkuar përmbarimin është i besueshëm, në të është treguar kreditori dhe debitori, shuma e cila duhet të paguhet, e njëjta është pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit.

Gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e LPP-së, kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate sipas shkresave të lëndës konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me nr.... të dt.20.05.2019, për shumën e detyrimit në vlerë prej 1,538.18 euro, i cili në mbështetje të dispozitave nga nenin 29 paragrafi 1 pika 1.3 dhe par 3 të LPP-së, e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm.

Pretendimet e debitorit, ku i referohet asaj se kreditori dhe debitori fillimisht është dashur të bëjnë barazimin e karteleve financiare dhe gjykata e shkallës së parë nuk e ka pasur parasysh këtë fakt, kjo gjykatë i refuzoj si të pa bazuara këto pretendime dhe atë konform nenit 69 të LPP –së, i cili përcakton se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”.* Në këtë rast debitori me anë të prapësimin nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi në rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur me këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e

përmbarimit në këtë rast

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.779/22

Gjyqtari
Krenar Berisha